



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Departamentit i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", nr.1, Tiranë;

E-mail: klsh.org.al; Web-site: www.klsh.org.al;

Nr. 487/7 Prot.

Tiranë, më 31.07.2018

V E N D I M

Nr. 99, Datë 31.07.2018

P Ë R

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË KOLONJË MBI AUDITIMIN E
RREGULLSHMËRISË
për periudhën nga data 01.01.2016 deri më datën 31.12.2017.**

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Kolonjë, rezultoi që veprimtaria ekonomike e financiare përputhet në përgjithësi me kërkesat dhe kriteret e kuadrit rregullator në fuqi në drejtim të planifikimit, miratimit, monitorimit dhe zbatimit të buxhetit. Për periudhën objekt i auditimit u konstatuan dhe të meta e dobësi me pasoja financiare në drejtim të procedurave të prokurimit dhe zbatimit të kontratave për punë publike.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga grupi i auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

V E N D O S A

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit të Rregullshmërisë të ushtruar në Bashkinë Kolonjë, sipas programit të auditimit nr. 487/1, datë 11.05.2018 për veprimtarinë nga data 01.01.2016 deri në 31.12.2017 dhe për ish-komunat nga data 01.01.2013 deri në 31.07.2015.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Kolonjë u konstatua se ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe realizimit të buxhetit. Sipas situacioneve të shpenzimeve të rakorduara me thesarin për vitin 2016 shpenzimet buxhetore në Bashkinë Kolonjë janë planifikuar në vlerën 507,041,299 lekë gjithsej dhe realizuar në vlerën 424,237,955 lekë gjithsej ose në masën 83.67 % me diferencë më pak në vlerën 82,803,344 lekë. Për vitin 2017, shpenzimet buxhetore në Bashkinë Kolonjë janë planifikuar në vlerën 712,619,023 lekë gjithsej dhe realizuar në vlerën 537,118,255 lekë gjithsej ose në masën 75.37 % me diferencë më pak në vlerën 175,500,768 lekë. Për vitin 2017, janë planifikuar 26 investime në vlerën 340,382,751 lekë, janë realizuar 22 investime dhe janë likuiduar 17, në vlerën 205,168,610 lekë ose në masën 60.28% me diferencë më pak në vlerën 135,214,141 lekë. Planifikimi i zërave të shpenzimeve dhe investimeve dhe mos realizimi i tyre për shkak të mos realizimit të të ardhurave sjellin mos plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës të njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve. Këshilli i Bashkisë Kolonjë nuk ka dokumentuar veprimtarinë e komisionit të financave, i cili vepron gjatë gjithë periudhës së mandatit, ky komision ka si funksion të kontrollojë të ardhurat dhe shpenzimet e kryera nga organi ekzekutiv, në përputhje me buxhetin e miratuar nga këshilli. Analizat e punës për realizimin e buxhetit paraardhës nuk janë bërë të plota, duke mos nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve të viteve të audituara. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 36-78 të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Kolonjë të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Nga Këshilli i Bashkisë Kolonjë të dokumentohet veprimtaria e komisionit të financave në mënyrë periodike, gjatë gjithë periudhës së mandatit, duke kontrolluar të ardhurat dhe shpenzimet e kryera nga organi ekzekutiv, në përputhje me buxhetin e miratuar nga Këshilli Bashkiak. Analizat e punës për realizimin e buxheteve paraardhës të bëhen duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve të viteve.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Kolonjë u konstatua se ka një vëllim të konsiderueshëm faturash të palikuiduara, në shumën totale prej 133,305,568 lekë, për shërbime dhe mallra të prokuruar, një pjesë e të cilave janë të trashëguara nga ish-komunat dhe një pjesë të krijuara pas reformës territoriale, si dhe 15,821,942 lekë nga vendime gjyqësore të formës së prerë. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 36-78 të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

2.1. Rekomandim: Në mënyrë që të mos krijohen fenomene të tilla dhe faturat të paguhen duke respektuar afatet ligjore, nga Bashkia Kolonjë të merren masa për monitorimin dhe shlyerjen e detyrimeve të bashkisë që diktohen nga vendime gjyqësore të formës së prerë, në mënyrë që të mos rëndohet buxheti i bashkisë me interesa apo penalitete të tjera për shkak të moslikuidimit të detyrimeve.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Regjistri për taksat dhe tarifave vendore për subjektet private dhe familjarët është krijuar në mënyrë manuale dhe elektronike, për Njësitë Administrative Ersekë, Leskovik, qendër Ersekë kurse Njësitë e tjera Administrative e kanë të krijuar në mënyrë manuale Qendër Leskovik, Barmash, Novoselë, Mollas dhe Çlirim. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 149-159 të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Të merren masa për krijimin e regjistrave elektronikë për taksat e familjarëve, qoftë për taksat e tokës ashtu edhe të tarifave të tjera për rritjen e mundësive të monitorimit në kohë reale dhe marrjen e masave për rritjen e performancës në mbledhjen e detyrimeve.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga sektori i të ardhurave (aktualisht Drejtoria e të ardhurave) nuk janë mbajtur rakordime me asnjë agjent tatimor, me përjashtim të informacionit mujor që dërgohet nga Drejtoria Rajonale Tatimore për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 149-159 të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Të merren masa për të kërkuar vazhdimisht rakordime me agjentët tatimorë dhe të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse. Në rast të mosreagimit nga këto institucione, të kërkohet zgjidhja e problemeve në rrugë administrative në instanca më të larta deri dhe në rrugë gjyqësore.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Referuar pasqyrave financiare të vitit 2017, Bashkia Kolonjë rezulton në fund të vitit me detyrime debitore (llogaria 468) “Debitorë të ndryshëm” në vlerën 28,213,547 lekë e cila përbën mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Kolonjë, përfshi vlerën e kamatëvonesave të llogaritur me 0,06% në ditë të detyrimit bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH.”, i ndryshuar, në mënyrë analitike si vijon:

- Debitorë nga biznesi i vogël në Ersekë për 77 subjekte në vlerën 2,483,837 lekë, nga të cilat 2,189,446 lekë detyrime të papaguara dhe 406,990 lekë kamatëvonesa.
- Debitorë biznesi i madh në Ersekë për 22 subjekte me vlerën 3,790,138 lekë, nga të cilat 3,307,151 lekë detyrime të papaguara dhe 482,987 lekë kamatëvonesa..
- Debitorë për 2 institucione në vlerën 785,600 lekë.
- Taksë familjare (pastrim, gjelbërim, ndriçim) në vlerën 1,788,700 lekë.
- Debitorë të Njësive Administrative të mbartura nga konsolidimi në shumën 211,691 lekë për 30 persona.
- Penalitete dhe kamatëvonesa të ndryshme në shumën 1,017,768 lekë.
- Debitorë të tjerë (konviktorë, punonjës, këshilltarë) në shumën 2,695,697 lekë.
- Debitorë të sportit 13,849 lekë.
- Debitorë të pa identifikuar në shumën 20,123 lekë.
- Debitorë të Njësive Administrative për taksën e tokës, ndërtesës, pastrim, ndriçim për ato njësi që ofrohet ky shërbim dhe për bizneset për njësitë që kanë biznese, në total 17,852,558 lekë, nga të cilat nuk janë kontabilizuar detyrimet për familjarët por që është në proces e sipër për të evidentuar këto detyrime dhe për të bërë veprimet përkatëse në kontabilitet pasi në momentet e konsolidimit këto detyrime nuk u paraqitën nga ish-komunat.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 36-78 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

5.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë, Drejtoria e financës, të marrë masa për sistemimin në kontabilitet të detyrimit prej 9,400,776 lek në ngarkim të subjekteve debitorë dhe 18,812,771 lekë në ngarkim të familjeve debitore dhe të kërkojë sipas ligjit, arkëtimin e këtyre vlerave nga personat përkatës juridik, fizik apo qytetar.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer, u konstatua se dokumentacioni për subjektet që ushtrojnë aktivitet privat në territorin e Bashkisë Kolonjë, aktualisht ndodhet në çdo njësi administrative. Kjo bie ndesh me përcaktimet në VKM nr. 510, datë 10.06.2015, “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial” dhe të Udhëzimit të Përbashkët të Ministrit për Çështjet

Vendore dhe ministrit të Financave nr. 3237, datë 16.7.2015 “Për procedurat, afatet kohore, standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm, për riorganizimin administrativo-territorial”.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 15-36 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

6.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë, të marrë masa për grumbullimin e të gjithë dokumentacionit në arkivin qendror të njësisë vendore, në përputhje me VKM dhe Udhëzimin e mësipërm. Në njësitë administrative mund të qëndrojnë kopje të këtij dokumentacioni, por gjithsesi, njësitë e dokumentacionit origjinal duhet të depozitohen menjëherë pranë arkivit të bashkisë.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se midis Bashkisë Kolonjë dhe ish-komunave me kompaninë A. janë lidhur 6 kontrata duke filluar që nga viti 2004 me një vlerë vjetore prej 1,900,000 lekë. Kjo kompani ka shlyer të gjitha detyrimet për këto kontrata, përveç kontratës së Radanjit e lidhur në datën 23.03.2004 deri më 22.03.2034 me ish komunën Qendër Leskovik, me vlerë 250.000 lekë. Kjo kontratë i nënshtrohet rivlerësimit sipas VKM-së 1064, të datës 22.12.2010 dhe kalon me shumën 400.000 lekë në vit, shumë të cilën kompania nuk e ka pranuar. Detyrimi i pa paguar nga kjo kompani për periudhën e audituar është 1.583.700 lekë. Ky detyrim nuk është kontabilizuar për vitin 2017.

Me kompaninë P. janë lidhur 3 kontrata duke filluar që nga viti 2010 me një vlerë vjetore prej 1.150.000 lekë lekë. Kjo kompani nuk ka shlyer detyrimet që nga data 24.09.2015 për kontratën G6401 Pepellash, 01.10.2015 për kontratën G6403 Ersekë, dhe 24.03.2016 për kontratën G6402 Leskovik. Ka njoftime për detyrimet e lindura për këtë kompani. Shuma e detyrimit për këtë kompani është në shumën 2.316.163 lekë, detyrim i pa kontabilizuar për vitin 2017. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 155-157 të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë, të kontabilizojë shumën e detyrimit prej 1,583,700 lekë në ngarkim të subjektit A. dhe shumën 2,316,163 lekë në ngarkim të subjektit P. dhe të kërkojë sipas ligjit, arkëtimin e këtyre vlerave nga personat përkatës juridikë, duke vazhduar me procedurat përkatëse administrative, ligjore dhe gjyqësore, përfshirë edhe prishjen e kontratave dhe heqjen e antenave nga territori i saj.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se nuk janë zbatuar kërkesat e neneve 90, 91 dhe 114 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, konkretisht “Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit”, (Neni 90) dhe “Masa e sigurimit të detyrimit tatimor” (Neni 91). *(Trajtuar më hollësisht në faqet 149-159 të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

8.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë, të marrë masa që, në rastet kur nuk arin të vjelë detyrimet tatimore nga personat juridikë dhe fizikë, pasi të ketë përfunduar procedura normale e njoftimit, të veprojnë në përputhje me klauzolat e neneve 90 dhe 91, të ligjit të përmendur më sipër, duke llogaritur edhe gjokat (kamatëvonesat përkatëse) sipas nenit 114 të ligjit në fjalë.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i strukturës së Policisë Bashkiake Kolonjë, konstatohet se:

- Emërimet e policëve bashkiakë nuk janë bërë nëpërmjet komisionit të përzgjedhjes së kandidatëve, duke mos marrë parasysh kërkesat e nenit 5 të ligjit i cili shprehet se “Kryetari i bashkisë apo i komunës emëron dhe shkarkon shefin e seksionit dhe inspektorët dhe policët të cilët përzgjidhen nga një komision i posaçëm që kryesohet nga kryeinspektori i rrethit për policinë e bashkisë e të

komunës dhe përbëhet nga një i deleguar i prefektit, si dhe një përfaqësues i komisariatit të policisë.”.

- Nuk janë marrë parasysh kërkesat e nenit 11 të Rregullores së brendshme “TIP” të Policisë Bashkiake, miratuar me Urdhrin e Përbashkët të Ministrisë së Pushtetit Vendorë dhe Ministrisë së Rendit Publik nr. 1, datë 17.04.2003 “Për miratimin e rregullores TIP të policisë bashkiake dhe të komunës”, në lidhje me emërimin nëpërmjet komisionit përzgjedhës.
- Në dosjet e punonjësve të policisë, të cilat i janë vënë në dispozicion grupit të audituesve të KLSH-së, ka të dhëna në lidhje me përvojën e punës së pjesës më të madhe të punonjësve të policisë bashkiake, trajnimet e tyre dhe pjesëmarrjen aktive në policinë e shtetit, por nuk disponohen të dhëna për trajnimet e tyre në zbatim të kërkesave të nenit 7 të ligjit pavarësisht se shumica e tyre kanë punuar si policë.
- Për emërimet e kryera nuk është marrë në konsideratë kriteri i moshës, sipas pikës 4, paragrafi 2 i po këtij neni, në të cilën thuhet: “- për polic duhet të ketë mbaruar shkollën e mesme dhe të jetë i moshës nga 19-27 vjeç.”.
- Në dokumentacionin që disponohet në Bashkinë Kolonjë, nuk ka asnjë të dhënë nëse punonjësit e policisë i janë nënshtruar ose jo betimit, në zbatim të nenit 6 të Rregullores së sipërpërmendur.
- Me punonjësit e policisë bashkiake, nuk janë lidhur kontrata pune me afat mbi tre vjeçar sipas kërkesave në aktet ligjore dhe nënligjore të cituara më sipër. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 159-161 të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

9.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë, të marrë masa për:

- Emërimin e punonjësve të Policisë Bashkiake sipas kërkesave ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në rastet e marrjes së punonjësve të rinj në punë të zbatohet procedura e përzgjedhjes nga komisioni i posaçëm, t’u nënshtrohen betimit sipas formulës së përcaktuar nga ligji, të respektohen kriteret e moshës, arsimit, kualifikimeve, t’i nënshtrohen betimit, etj.
- Punonjësit e Policisë Bashkiake t’i nënshtrohen trajnimeve dhe kualifikimeve, sipas përcaktimeve ligjore.
- Lidhjen e kontratave të punës me afat mbi dy vjeçar.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Kolonjë nuk janë ndërmarrë hapat ligjore për regjistrimin e pronave në pronësi të Bashkisë në ZVRPP Kolonjë, në zbatim të kritereve dhe procedurave të përcaktuara në VKM nr. 500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 161-162 të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

10.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të marrë masat e nevojshme për regjistrimin e pronave dhe për krijimin e regjistrimit të pronave të paluajtshme të kaluara në pronësi, apo në përdorim të Bashkisë Kolonjë, në zbatim të VKM nr. 500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se për periudhën objekt auditimi në strukturën e bashkisë Kolonjë për vitet 2016-2017 nuk është ngritur struktura e IMTV-së pranë bashkisë dhe nuk i ka deleguar me shkresë zyrtare përgjegjësitë dhe detyrat e përcaktuara Këshillit të Qarkut Korçë duke vepruar në kundërshtim me detyrimet ligjore të përcaktuara në nenet 4, 5, 6 dhe 18.1 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 159-161 të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

11.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të marrë masa për ngritjen e strukturës së IMTV-së pranë Bashkisë Kolonjë në përmbushje të neneve 6 dhe 18.1 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Në Njësinë shpenzuese, Bashkia Kolonjë për periudhën raportuese 2016 u konstatua se, ndërmjet gjendjes fizike të vlerave të aktiveve dhe gjendjes kontabile e pasqyruar në pasqyrën financiare rezultojnë diferenca në gjendjen fizike dhe kontabile, ndërsa për periudhën raportuese 2017 si pasojë e mos përfundimit brenda afatit të procesit të inventarizimit fizik të aktiveve dhe vlerave materiale, mos nxjerrja e rezultatit dhe sistemimi diferencave brenda periudhës së ndërtimit të pasqyrave financiare nuk mund të quhet se ato pasqyrojnë realitetin e gjendjes së pasurisë të institucionit. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 36-78 të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

12.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë, Zyra e Financës dhe Kontabiliteti të marr masat të plota për të sistemuar diferencat e rezultuara ndërmjet gjendjes fizike dhe kontabile të periudhës raportuese 2016, si dhe përfundimin e menjëhershëm të procesit të inventarizimit fizik të aktiveve të pasurisë e aseteve të institucionit me qëllim saktësimin e gjendjes fizike e kontabile për periudhën raportuese 2017.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes teknike të objektit “Rruga hyrëse në fshatin Selenicë, Starje dhe Taç-Lartë” rezultoi se ky objekt ishte prokuruar dhe zbatuar pa marrë leje ndërtimi, në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 78-90 të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

13.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Kolonjë të merren masa që, përpara tenderimit të fondeve për ndërtim të objekteve apo vepra të infrastrukturës, të ndiqen procedurat e marrjes së lejes së ndërtimit, në mënyrë që objektet të realizohen sipas projektit dhe preventivit të miratuar.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Bashkia Kolonjë nuk ka funksionuar në bazë strategjish periodike dhe objektiva prioritar. Nga auditimi dhe komunikimi me subjektin rezulton se për periudhën objekt i auditimit në Bashkinë Kolonjë nuk janë parashikuar plane vjetore dhe operacionale aktivitetesh për realizimin e objektivave por ndjekja e realizimit të detyrave dhe përgjegjësive të përkrahura në Rregulloren e brendshme si dhe monitorimi e raportimi funksionojnë në mënyrë operative si dhe nuk ka aplikuar metodën e vlerësimit dhe menaxhimit të risqeve që kërcënojnë realizimin e objektivave dhe respektivisht realizimin e funksioneve kryesore të ngarkuara sipas kuadrit rregullator në fuqi. Nga auditimi i evidencës së grumbulluar, raportimet e nivelit drejtues dhe përgjigjet e stafit të administratës në pyetësorët e aplikuar për këtë qëllim rezulton se nuk janë organizuar trajnime për rritjen e kapaciteteve profesionale dhe veçanërisht në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 15-36 të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

14.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë, në ushtrim të përgjegjshmërisë menaxheriale të institucionit që drejton, të formojë një grup pune me specialistë me njohuri të spikatura profesionale me qëllim që:

a) Të organizojë punën për vlerësimin e situatës aktuale të veprimtarisë së bashkisë, identifikimin e dobësive, kërcënimeve dhe oportuniteteve dhe ndërtimin e strategjisë afatmesme e afatshkurtër të bashkisë duke marrë në konsideratë prioritetet e bashkisë në vijimësi.

b) Pas përfshirjes në strategji të rritjes dhe forcimit të kapaciteteve profesionale si objektiv prioritar, të vlerësojë nevojat për trajnime të stafit kryesisht në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm dhe të hartojë plane vjetore dhe operacionale aktivitetesh për realizimin e objektivave në tërësi dhe ato në fushën e trajnimeve në veçanti.

Menjëherë

14.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë nëpërmjet koordinatorit të riskut të ndërtojë një plan pune me detyra të mirë përcaktuara për të organizuar punën në bashki për aplikimin e funksionimit të institucionit me bazë vlerësimin dhe menaxhimin e riskut në çdo nivel të administratës dhe dokumentimin në regjistrin qendror të riskut në vazhdimësi si rezultat i rishikimit dhe rivlerësimit të risqeve me qëllim garantimin e arsyeshëm dhe në nivel sa më optimal të realizimit të objektivave dhe misionit të bashkisë.

Rekomandimet sa më sipër, në referencë të përcaktimeve në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, neni 8, pika 8; neni 10; neni 16; neni 21; dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010.

Menjëherë

B/1 MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH* dhe, mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”; nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe, pikën 93, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga Titullari i Njesisë Publike, pas vlerësimit të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në total në vlerën **30,880,941 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Kolonjë, subjekteve qiramarrëse të cilët nuk kanë përmbushur rregullisht detyrimin kontraktor, nuk ju është aplikuar sanksioni i parashikuar në pikën 2 të “Kontratës TIP”, përlllogaritja e gjobës 1% të detyrimit për çdo ditë vonesë në pagesën e qirasë jashtë afateve kontraktore, të përcaktuar në kushtet e kontratës, duke i shkaktuar buxhetit NJQV Bashkisë Kolonjë dëm ekonomik në vlerën 1,074,698 lekë e cila përbën kamatëvonesën si pasojë e mospërmbushjes të detyrimeve kontraktuale në afat nga qiramarrësit. (*Trajtuar në faqet 155-157 të Raportit Përfundimtar të auditimit*)

1.1. Rekomandim: Bashkia Kolonjë të marrë masa duke kontabilizuar dhe kërkuar në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit ndaj qiramarrësve për arkëtimin e vlerës prej **1,074,698 lekë**, konkretisht:

- vlerën prej 400,000 ndaj subjektit “[REDACTED]”;
- vlerën prej 535,375 ndaj subjektit “[REDACTED]”;
- vlerën prej 139,323 ndaj subjektit “[REDACTED]”.

Deri më 31.12.2018

2. Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar me objekt “*Rruga hyrëse në fshatin Selenice, Starje dhe Taç-Lartë*” është shkaktuar dëmi ekonomik në shumën 13,357,430 lekë pa tvsh për buxhetin e Bashkisë Kolonjë, i shkaktuar si rezultat i skualifikimit të ofertës ekonomike me vlerë më të ulët dhe vlerësimin e ofertës ekonomike me vlerë më të lartë, në mospërputhje me neni 52 “*Hapja e ofertave*” pikat (1), (6), neni 53/4 “*Shqyrtimi ofertave*”, neni 54 “*Alternativat*”, neni 55 “*Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese*” të LPP. (*Trajtuar në faqet 116-119 të Raportit Përfundimtar të auditimit*)

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësisë për zhdëmtimin e vlerës **13,357,430 lekë**, ndaj personave përgjegjës për procedurën e prokurimit, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet

publike ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruara, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Brenda vitit 2018

3. Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar me objekt “*Rikonstrukcion i zyrave të bashkisë*” është shkaktuar dëmi ekonomik në shumën 150,843 lekë pa tvsh për buxhetin e Bashkisë Kolonjë, shpenzim i paligjshëm i shkaktuar si rezultat i skualifikimit të ofertës ekonomike me vlerë me të ulët dhe vlerësimin e ofertës ekonomike me vlerë më të lartë, në mospërputhje me neni 52 “*Hapja e ofertave*” pikat (1); (6), neni 53/4 “*Shqyrtimi ofertave*”, neni 54 “*Alternativat*”, neni 55 “*Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese*” të LPP. (Trajtuar në faqet 120-123 të Raportit Përfundimtar të auditimit)

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësisë për zhdëmtimin e vlerës **150,843 lekë pa tvsh**, ndaj personave përgjegjës për procedurën e prokurimit, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruara, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Brenda vitit 2018

4. Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar me objekt “*Blerje materiale për pastrim, dezinfektim, etj.*” është shkaktuar dëmi ekonomik në shumën 174,817 lekë pa tvsh për buxhetin e Bashkisë Kolonjë, shpenzim i paligjshëm i shkaktuar si rezultat i skualifikimit të ofertës ekonomike me vlerë me të ulët dhe vlerësimin e ofertës ekonomike me vlerë më të lartë, në mospërputhje me nenin 52 “*Hapja e ofertave*” pikat (1); (6), neni 53/4 “*Shqyrtimi ofertave*”, neni 54 “*Alternativat*”, neni 55 “*Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese*” të LPP. (Trajtuar në faqet 141-143 të Raportit Përfundimtar të auditimit)

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësisë për zhdëmtimin e vlerës **174,817 lekë pa tvsh**, ndaj personave përgjegjës për procedurën e prokurimit, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruara, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Brenda vitit 2018

5. Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar me objekt “*Rrjeti ujitës rezervuari Kabash i pjesshëm*” është shkaktuar dëmi ekonomik në shumën 4,810,727 lekë pa tvsh për buxhetin e Bashkisë Kolonjë, shpenzim i paligjshëm i shkaktuar si rezultat i skualifikimit të ofertës ekonomike me vlerë me të ulët dhe vlerësimin e ofertës ekonomike me vlerë më të lartë, në mospërputhje me neni 52 “*Hapja e ofertave*” pikat (1); (6), neni 53/4 “*Shqyrtimi ofertave*”, neni 54 “*Alternativat*”, neni 55 “*Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese*” të LPP. (Trajtuar më hollësisht në faqet 134-136 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

5.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësisë për zhdëmtimin e vlerës **4,810,727 lekë**, ndaj personave përgjegjës për procedurën e prokurimit, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruara, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Brenda vitit 2018

6. Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar me objekt “*Rikualifikim i qendrës së qytetit Leskovik*” është shkaktuar dëmi ekonomik në shumën 6,631,768 lekë pa tvsh për buxhetin e Bashkisë Kolonjë, shpenzim i paligjshëm i shkaktuar si rezultat i skualifikimit të ofertës ekonomike me vlerë me të ulët dhe vlerësimin e ofertës ekonomike me vlerë më të lartë, në mospërputhje me neni 52 “*Hapja e*

ofertave” pikat (1); (6), neni 53/4 “Shqyrtimi ofertave”, neni 54 “Alternativat”, neni 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese” të LPP. (Trajtuar më hollësisht në faqet 126-133 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

6.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësisë për zhdëmtimin e vlerës **6,631,768 lekë**, ndaj personave përgjegjës për procedurën e prokurimit, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Brenda vitit 2018

7. Gjetje nga auditimi: Në kontratën e furnizimit nr. 3, datë 05.04.2017 objekti “Blerje materiale për rikonstruksionin e zyrave të bashkisë” me afat 30 ditë nga nënshkrimi i kontratës është shkaktuar dëmi ekonomik në shumën 144,632 lekë me tvsh për buxhetin e Bashkisë Kolonjë, shpenzim i paligjshëm i shkaktuar si rezultat i dorëzimit me 67 ditë vonesë të artikujve jashtë afatit të parashikuar në kontratë, ndërsa komisioni i marrjes në dorëzim nuk ka përllogaritur dëmin e shkaktuar si pasojë e dorëzimit me vonesë, në mospërputhje me nenin 24 “Likuidimi i dëmeve për dorëzim të vonuar”, germa (a); “Për kontrata me periudhë zbatimi jo më shumë se 6/muaj tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës...”. (Trajtuar më hollësisht në faqet 120-123 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

7.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të marr masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës prej **144,632 lekë me tvsh**, nga subjekti kontraktues “██████████” person fizik.

Brenda vitit 2018

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Gjelbërimi i mjediseve publike të qytetit Ersekë”, Bashkia Kolonjë, me vlerë të kontratës 40,674,317 lekë me tvsh, fituar nga Operatori Ekonomik “██████████” Sh.p.k, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 2,891,500 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2573 prot., datë 14.10.2016 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kolonjë dhe Operatori Ekonomik “Alb Garden” Sh.p.k. (Trajtuar më hollësisht në faqet 78-82 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

8.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Kolonjë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **2,891,500 lekë pa tvsh** nga Operatori Ekonomik “██████████” Sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 2573 prot., datë 14.10.2016 me objekt “Gjelbërimi i mjediseve publike të qytetit Ersekë”, Bashkia Kolonjë, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda vitit 2018

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rruga hyrëse në fshatin Selenicë, Starje dhe Taç-Lartë”, Bashkia Kolonjë, me vlerë të kontratës 95,016,290 lekë me tvsh, fituar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “██████████” Sh.p.k, dhe “██████████”, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 1,281,236 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1510 prot datë 22.05.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kolonjë dhe BOE “A.” Sh.p.k, dhe “N.” Sh.p.k. (Trajtuar më hollësisht në faqet 82-90 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

9.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Kolonjë të merren masa për kompensimin e vlerës prej **1,281,236 lekë pa tvsh** nga BOE “██████████” Sh.p.k, dhe “██████████”, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 1510 prot datë 22.05.2017 me objekt “Rruga hyrëse në fshatin Selenicë, Starje dhe Taç-Lartë”,

Bashkia Kolonjë, nëpërmjet realizimit të zërave të punimeve që rezultojnë me diferenca sipas analizës së trajtimit në Raportin Përfundimtar të auditimit duke qenë se ekzistojnë mundësitë fizike objektivist.

Brenda vitit 2018

10. Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar me objekt “Rikonstruksion sistemi ngrohjes i shkollës së mesme” është shkaktuar dëmi ekonomik në shumën 363,290 lekë pa tvsh për buxhetin e ish-Bashkia Leskovik, shpenzim i paligjshëm i shkaktuar si rezultat i s’kualifikimit të ofertës ekonomike me vlerë me të ulët dhe vlerësimin e ofertës ekonomike me vlerë më të lartë, në mospërputhje me neni 52 “Hapja e ofertave” pikat (1); (6), neni 53/4 “Shqyrtimi ofertave”, neni 54 “Alternativat”, neni 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese” të LPP. (Trajtuar më hollësisht në faqet 144-147 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

10.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësisë për zhdëmtimin e vlerës **363,290 lekë pa tvsh**, ndaj personave përgjegjës për procedurën e prokurimit, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Brenda vitit 2018

B/2. PËRDORIM JO ME EFIKTIVITET, EFICENCË DHE EKONOMICITET I SHPENZIMEVE NË FUSHËN E PROKURIMEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Në 3 procedura prokurimi gjatë vitit 2016, me vlerë kontrate me tvsh në shumën 10,046,000 lekë, me objekt prokurimi respektivisht {“Blerje Makinë Zjarrfikëse për Bashkinë Kolonjë ”; “Blerje Makinë Teknologjike për grumbullimin e mbetjeve urbane” (Kamion)” ; “Ndriçim Publik LED Fshati Rehove, Gostivisht, Selenicë, Boshanj, Starje”} janë konstatuar parregullsi në shpalljen fitues të OE me mangësi në plotësimin e kriterëve sipas DST, veprime në mospërputhje me nenin 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, shkronja (a, b, d, dh), nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, shkronja (a, b, c), nenin 46 pika 1, nenin 53 pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. (Trajtuar në faqet 98-102 të Raportit Përfundimtar të auditimit)

1.1 Rekomandimi: Bashkia Kolonjë nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **8,371,667 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

2. Gjetje nga auditimi: Në tenderi e zhvilluar me objekt “Blerje mjete transporti fuoristrade me karroceri 4x4” me vlerë 1,860,000 lekë me tvsh e cila përbën vlerën totale të kontratës së lidhur dhe likuiduar pas marrjes në dorëzim të mjetit fuoristrade me karroceri 4x4, pa plotësuar kërkesat e specifikimeve teknike të DST, për pasojë kontrata është likuiduar për mall jashtë kushteve teknike, në mospërputhje me kërkesat e parashikuara nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ç’ka përbën efekt financiar negativ për llogari të buxhetit të Bashkisë Kolonjë. (Trajtuar në faqet 137-140 të Raportit Përfundimtar të auditimit)

2.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor të analizojë vlerën **1,860,000 lekë me tvsh**, pagesë e cila përbën efekt financiar negativ për buxhetin e Bashkisë Kolonjë, në lidhje me realizimin e kontratës për blerjen e mjetit fuoristrade me karroceri 4x4 e marrë në dorëzim pa plotësuar specifikimet teknike të miratuara me DST, duke nxjerr përgjegjësinë ndaj komisionit të marrjes në dorëzim të mjetit.

3. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzim nr. 174, datë 19.06.2014 është kryer pagesë në shumën 399,718 lekë me përfitues subjekti “██████████” shpk për likuidim shpenzimi me objekt; “*Rikonstruksion rruge Zylyftar Poda*”, pagesë e kryer pa dokumenta shoqëruese justifikuese aktkolaudim dhe aktmarrje në dorëzim të punimeve të kryera, ndërsa vërtetimi për marrje në dorëzim evidenton marrje në dorëzim të faturës lëshuar dhe jo marrje në dorëzim të punimeve dhe të cilësisë së punimeve, për pasojë likuidimi është kryer me dokumenta shoqëruese të pa justifikuara për punimet e kryera, në mospërputhje me ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” neni 4/24;10; 11; 12; UMF nr.30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik*”, pika 35; 36 dhe pika 7 e Udhëzimit nr. 3, datë 27.01.2015, çka përbën efekt financiar negativ për llogari të buxhetit të ish-Bashkisë Leskovik. (*Trajtuar në faqet 70-71 të Raportit Përfundimtar të auditimit*)

3.1. Rekomandimi: Titullari i njësisë shpenzuese Bashkia Kolonjë të analizojë vlerën **399,718 lekë**, pagesë e cila **përbën efekt financiar negativ** për buxhetin ish-Bashkisë Leskovik, duke analizuar dokumentat justifikuese të likuidimit dhe të nxjerr përgjegjësi për punimet e kryera në objekt.

4. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzim nr. 182, datë 03.07.2014 është kryer pagesë në shumën 399,420 lekë me përfitues subjekti “██████████” shpk për likuidim shpenzimi me objekt; “*Rikonstruksion rruge përgjatë rrugës Përmetit*”, pagesë e kryer pa dokumenta shoqëruese justifikuese aktkolaudim dhe aktmarrje në dorëzim të punimeve të kryera, ndërsa vërtetimi për marrje në dorëzim evidenton marrje në dorëzim të faturës lëshuar dhe jo marrje në dorëzim të punimeve dhe të cilësisë së punimeve, për pasojë likuidimi është kryer me dokumenta shoqëruese të pa justifikuara për punimet e kryera, në mospërputhje me ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” neni 4/24;10; 11; 12; UMF nr.30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik*”, pika 35; 36 dhe pika 7 e Udhëzimit nr.3, datë 27.01.2015, çka përbën efekt financiar negativ për llogari të buxhetit të ish/Bashkisë Leskovik (*Trajtuar më hollësisht në faqet 71-72 të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

4.1. Rekomandimi: Titullari i njësisë shpenzuese Bashkia Kolonjë të analizojë vlerën **399,420 lekë**, pagesë e cila **përbën efekt financiar negativ** për buxhetin e ish-Bashkisë Leskovik, duke analizuar dokumentat justifikuese të likuidimit dhe të nxjerr përgjegjësi për punimet e kryera në objekt.

5. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzim nr. 200, datë 18.07.2014 është kryer pagesë në shumën 399,800 lekë me përfitues subjekti “██████████” shpk për likuidim shpenzimi me objekt; “*rikonstruksion rruga e gurtë*”, pagesë e kryer pa dokumenta shoqëruese justifikuese aktkolaudim dhe aktmarrje në dorëzim të punimeve të kryera, ndërsa vërtetimi për marrje në dorëzim evidenton marrje në dorëzim të faturës lëshuar dhe jo marrje në dorëzim të punimeve dhe të cilësisë së punimeve, për pasojë likuidimi është kryer me dokumenta shoqëruese të pa justifikuara për punimet e kryera, në mospërputhje me ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” neni 4/24;10; 11; 12; UMF nr.30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik*”, pika 35; 36 dhe pika 7 e Udhëzimit nr.3, datë 27.01.2015, çka përbën efekt financiar negativ për llogari të buxhetit të ish/Bashkisë Leskovik. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 72-73 të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

5.1. Rekomandimi: Titullari i njësisë shpenzuese Bashkia Kolonjë të analizojë vlerën **399,800 lekë**, pagesë e cila **përbën efekt financiar negativ** për buxhetin e ish-Bashkisë Leskovik, duke analizuar dokumentat justifikuese të likuidimit dhe të nxjerr përgjegjësi për punimet e kryera në objekt.

6. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzim nr. 219, datë 08.08.2014 është kryer pagesë në shumën 398,100 lekë me përfitues subjekti “██████████” për likuidim shpenzimi me objekt; “*Rikonstruksion rruga së rrëzës blloku nr.1*”, pagesë e kryer pa dokumenta shoqëruese justifikuese aktkolaudim dhe aktmarrje në dorëzim të punimeve të kryera, ndërsa vërtetimi për marrje në dorëzim evidenton marrje në dorëzim

të faturës lëshuar dhe jo marrje në dorëzim të punimeve dhe të cilësisë së punimeve, për pasojë likuidimi është kryer me dokumenta shoqëruese të pa justifikuar për punimet e kryera, në mospërputhje me ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4/24;10; 11; 12; UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, pika 35; 36 dhe pika 7 e Udhëzimit nr.3, datë 27.01.2015, çka përbën efekt financiar negativ për llogari të buxhetit të ish/Bashkisë Leskovik (Trajtuar më hollësisht në faqet 72-73 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

6.1. Rekomandimi: Titullari i njësisë shpenzuese Bashkia Kolonjë të analizojë vlerën **398,100 lekë**, pagesë e cila **përbën efekt financiar negativ** për buxhetin e ish-Bashkisë Leskovik, duke analizuar dokumentat justifikuese të likuidimit dhe të nxjerr përgjegjësi për punimet e kryera në objekt.

7. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzim nr. 253, datë 10.09.2014 është kryer pagesë në shumën **199,580 lekë** me përfitues subjekti “██████████” për likuidim shpenzimi me objekt; “Murë mbajtës në rruga e shkollës”, pagesë e kryer pa dokumenta shoqëruese justifikuese aktkolaudim dhe aktmarrje në dorëzim të punimeve të kryera, ndërsa vërtetimi për marrje në dorëzim evidenton marrje në dorëzim të faturës lëshuar dhe jo marrje në dorëzim të punimeve dhe të cilësisë së punimeve, për pasojë likuidimi është kryer me dokumenta shoqëruese të pa justifikuar për punimet e kryera, në mospërputhje me ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4/24;10; 11; 12; UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, pika 35; 36 dhe pika 7 e Udhëzimit nr.3, datë 27.01.2015, çka përbën efekt financiar negativ për llogari të buxhetit të ish-Bashkisë Leskovik.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 72-74 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

7.1. Rekomandimi: Titullari i njësisë shpenzuese Bashkia Kolonjë të analizojë vlerën **199,580 lekë**, pagesë e cila **përbën efekt financiar negativ** për buxhetin e ish-Bashkisë Leskovik, duke analizuar dokumentat justifikuese të likuidimit dhe të nxjerr përgjegjësi për punimet e kryera në objekt.

8. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzim nr. 254, datë 10.09.2014 është kryer pagesë në shumën **65,430 lekë** me përfitues subjektin “██████████” për likuidim shpenzimi me objekt; “Riparime në shkollat e mesme”, pagesë e kryer pa dokumenta shoqëruese justifikuese aktkolaudim dhe aktmarrje në dorëzim të punimeve të kryera, ndërsa vërtetimi për marrje në dorëzim evidenton marrje në dorëzim të faturës lëshuar dhe jo marrje në dorëzim të punimeve dhe të cilësisë së punimeve, për pasojë likuidimi është kryer me dokumenta shoqëruese të pa justifikuar për punimet e kryera, në mospërputhje me ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4/24;10; 11; 12; UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, pika 35; 36 dhe pika 7 e Udhëzimit nr.3, datë 27.01.2015, çka përbën efekt financiar negativ për llogari të buxhetit të ish/Bashkisë Leskovik (Trajtuar më hollësisht në faqet 72-74 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

8.1. Rekomandimi: Titullari i njësisë shpenzuese Bashkia Kolonjë të analizojë vlerën **65,430 lekë**, pagesë e cila **përbën efekt financiar negativ** për buxhetin e ish-Bashkisë Leskovik, duke analizuar dokumentat justifikuese të likuidimit dhe të nxjerr përgjegjësi për punimet e kryera në objekt.

9. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzim nr. 273, datë 03.10.2014 është kryer pagesë në shumën **399,800 lekë** me përfitues subjekti “██████████” për likuidim shpenzimi me objekt; “Rikonstruksion rruga e shkollës blloku nr. 2”, pagesë e kryer pa dokumenta shoqëruese justifikuese akt-kolaudim dhe aktmarrje në dorëzim të punimeve të kryera, ndërsa vërtetimi për marrje në dorëzim evidenton marrje në dorëzim të faturës së lëshuar dhe jo marrje në dorëzim të punimeve dhe të cilësisë së punimeve, për pasojë likuidimi është kryer me dokumenta shoqëruese të pa justifikuar për punimet e kryera, në mospërputhje me ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni

4/24;10; 11; 12; UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, pika 35; 36 dhe pika 7 e Udhëzimit nr. 3, datë 27.01.2015, çka përbën efekt financiar negativ për llogari të buxhetit të ish/Bashkisë Leskovik.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 72-74 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

9.1. Rekomandimi: Titullari i njësisë shpenzuese Bashkia Kolonjë të analizojë vlerën **399,800 lekë**, pagesë e cila **përbën efekt financiar negativ** për buxhetin e ish-Bashkisë Leskovik, duke analizuar dokumentat justifikuese të likuidimit dhe të nxjerr përgjegjësi për punimet e kryera në objekt.

10. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzim nr. 116, datë 19.06.2015 është kryer pagesë në shumën **102,400 lekë** me përfitues subjekti “██████████” shpk për likuidim shpenzimi me objekt; “Blerje karburant”, pagesë e kryer pa dokumenta shoqëruese justifikuese ndërsa blerja e kryer është e pa justifikuar me qëllimin e shpenzimit, sepse nuk ka argumentim të nevojës së blerjes së artikullit nga zyra përkatëse, njëkohësisht është periudhë e riorganizimit në zbatim të procedurave të VKM nr.510, datë 10.06.2015, në mospërputhje me ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4/24;10; 11; 12; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, pika 35; 36 dhe pika 7 e Udhëzimit nr.3, datë 27.01.2015, çka përbën efekt financiar negativ për llogari të buxhetit të ish/Bashkisë Leskovik. (Trajtuar më hollësisht në faqet 72-74 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

10.1. Rekomandimi: Titullari i njësisë shpenzuese Bashkia Kolonjë të analizojë vlerën **102,400 lekë**, pagesë e cila **përbën efekt financiar negativ** për buxhetin e ish-Bashkisë Leskovik, duke analizuar dokumentat justifikuese të likuidimit dhe të nxjerr përgjegjësi për punimet e kryera në objekt.

11. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzim nr. 63, datë 09.04.2015 është kryer pagesë në shumën **174,900 lekë** me përfitues subjekti “██████████” shpk për likuidim shpenzimi me objekt; “Blerje karburant”, pagesë e kryer pa dokumenta shoqëruese justifikuese ndërsa blerja e kryer është e pa justifikuar me qëllimin e shpenzimit, sepse nuk ka argumentim të nevojës së blerjes së artikullit nga zyra përkatëse, njëkohësisht është periudhë e riorganizimit në zbatim të procedurave të VKM nr.510, datë 10.06.2015, në mospërputhje me ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4/24;10; 11; 12; UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, pika 35; 36 dhe pika 7 e Udhëzimit nr.3, datë 27.01.2015, çka përbën efekt financiar negativ për llogari të buxhetit të ish-Bashkisë Leskovik. (Trajtuar më hollësisht në faqet 72-74 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

11.1. Rekomandimi: Titullari i njësisë shpenzuese Bashkia Kolonjë të analizojë vlerën **174,900 lekë**, pagesë e cila **përbën efekt financiar negativ** për buxhetin e ish-Bashkisë Leskovik, duke analizuar dokumentat justifikuese të likuidimit dhe të nxjerr përgjegjësi për furnizimin e kryer.

12. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzim nr. 45, datë 25.03.2015 është kryer pagesë në shumën **149,900 lekë** me përfitues subjekti “██████████”shpk për likuidim shpenzimi me objekt; “Blerje karburant”, pagesë e kryer pa dokumente shoqëruese justifikuese,ndërsa blerja e kryer është e pa justifikuar me qëllimin e shpenzimit, sepse nuk ka argumentim të nevojës së blerjes së artikullit nga zyra përkatëse, njëkohësisht është periudhë e riorganizimit në zbatim të procedurave të VKM nr.510, datë 10.06.2015, në mospërputhje me ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4/24;10; 11; 12; UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, pika 35; 36 dhe pika 7 e Udhëzimit nr.3, datë 27.01.2015, çka përbën efekt financiar negativ për llogari të buxhetit të ish/Bashkisë Leskovik. (Trajtuar më hollësisht në faqet 72-74 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

12.1. Rekomandimi: Titullari i njësisë shpenzuese Bashkia Kolonjë të analizojë vlerën **149,900 lekë**, pagesë e cila *përbën efekt financiar negativ* për buxhetin e ish-Bashkisë Leskovik, duke analizuar dokumentat justifikuese të likjimit dhe tënxjerr përgjegjësi për furnizimin e kryer.

13. Gjetje nga auditimi: Në kontratën e shitjes datë 22.07.2013 me subjekti “XXXXXXXXXX” shpk e likuiduar në masën e plotë me objekt “*Rikonstrukcion sistemi ngrohjes i shkollës së mesme*” me vlerë 2,013,612 lekë me tvsh, në preventivi ofertës dhe situacion është parashikuar në zërin nr. 5 “*Heqje e kaldajës ekzistuese*” dhe në zërin nr. 16 “*F.V kaldajë celiku 350 Mkal/orë*” ndërkohë që në aktkolaudim dhe akt-marrje në dorëzim të punimeve, mbikqyrësi punimeve dhe kolaudatori nuk kanë pasqyruar dhe evidentuar heqjen e kaldajës ekzistuese dhe dorëzimin pranë njësisë shpenzuese e cila duhet ta dokumentonte gjendje në magazine me vlerën kontabile e paraqitur me inventarizimin fizik nga viti 2013 në shumën 6,881,961 lekë, veprime në mospërputhje me kushtet e kontratës pika 5 dhe 16 të preventivit të ofertës. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 144-147 të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

13.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të marr masa dhe të analizojë vlerën **6,881,961 lekë** e cila *përbën efekt financiar negativ* për buxhetin e ish-Bashkia Leskovik, aktualisht Njësia Administrative, në lidhje me administratimin e artikullit “Kaldajë”, duke nxjerr përgjegjësinë ndaj mbikqyrësit, kolaudatorit dhe komisionit të marrjes në dorëzim të punimeve.

14. Gjetje nga auditimi: Me procesverbalin e asgjësimit të vlerave materiale të vlerësuara jashtë përdorimit, për artikulli nr. 2 “*Laptop Hp 610*” me vlerë *140,000 lekë* e artikulli nr.7 “*Kompjuter + Printer*” me vlerë *216,000 lekë*, pa saktësuar sasi e vlerë të çdo artikull në vlerën totale prej *356,000 lekë* të asgjësuar pa relacion e raport teknik nga specialistë të informatikës, në mospërputhje me ligjin nr.8652, datë 31.07.2000 “*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*”, ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015, ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin e pasqyrat financiare*”, pika 1, neni 7 “*Inventari i aktiveve e detyrimeve*”; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, Kreu IV “*Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, inventarizimi i aktiveve*” dhe UMF nr. 28, datë 15.12.2011 “*Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit te kontrollit te brendshëm në njësite publike*”, (*Trajtuar më hollësisht në faqet 64-66 të Raportit të Auditimit*).

14.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të marr masat dhe të analizojë vlerën **356,000 lekë** e cila *përbën efekt financiar negativ* për buxheti ish/Bashkia Leskovik aktualisht (njësi administrative) në lidhje me asgjësimin pa relacion dhe raport teknik nga specialistë të informatikës, si dhe pa evidentuar vit prodhimi për artikujt, duke nxjerr përgjegjësinë ndaj anëtarëve të komisionit të vlerësimit dhe asgjësimit.

B/3. TË ARDHURA TË MUNGUARA

1. Gjetje nga auditimi: Referuar pasqyrave financiare të vitit 2017, Bashkia Kolonjë rezulton në fund të vitit me detyrime debitore (llogaria 468) “*Debitorë të ndryshëm*” në vlerën 28,213,547 lekë e cila përbën mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Kolonjë, përfshi vlerën e kamatëvonesave të llogaritur me 0,06% në ditë të detyrimit bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për Procedurat tatimore në R.SH.*”, i ndryshuar, në mënyrë analitike si vijon:

- Debitorë nga biznesi i vogël në Ersekë për 77 subjekte në vlerën 2,483,837 lekë, nga të cilat 2,189,446 lekë detyrime të papaguara dhe 406,990 lekë kamatëvonesa.
- Debitorë biznesi i madh në Ersekë për 22 subjekte me vlerën 3,790,138 lekë, nga të cilat 3,307,151 lekë detyrime të papaguara dhe 482,987 lekë kamatëvonesa..
- Debitorë për 2 institucione në vlerën 785,600 lekë.
- Taksë familjare (pastrim, gjelbërim, ndriçim) në vlerën 1,788,700 lekë.
- Debitorë të Njësive Administrative të mbartura nga konsolidimi në shumën 211,691 lekë për 30 persona.
- Penalitete dhe kamatëvonesa të ndryshme në shumën 1,017,768 lekë.
- Debitorë të tjerë (konviktorë, punonjës, këshilltarë) në shumën 2,695,697 lekë.
- Debitorë të sportit 13,849 lekë.
- Debitorë të pa identifikuar në shumën 20,123 lekë.
- Debitorë të Njësive Administrative për taksën e tokës, ndërtesës, pastrim, ndriçim për ato njësi që ofrohet ky shërbim dhe për bizneset për njësitë që kanë biznese, në total 17,852,558 lekë, nga të cilat nuk janë kontabilizuar detyrimet për familjarët por që është në proces e sipër për të evidentuar këto detyrime dhe për të bërë veprimet përkatëse në kontabilitet pasi në monentet e konsolidimit këto detyrime nuk u paraqitën nga ish-komunat.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 36-78 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

1.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë, Drejtoria e financës, të marrë masa për sistemimin në kontabilitet të detyrimit prej 9,400,776 lek në ngarkim të subjekteve debitorë dhe 18,812,771 lekë në ngarkim të familjeve debitorë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë dhe të kërkojë sipas ligjit, arkëtimin e këtyre vlerave nga personat përkatës juridik, fizik apo qytetar.

2. Gjetje nga auditimi: Në kontratën e furnizimit nr. 3, datë 05.04.2017 objekti “*Shfrytëzim i materialit drusor të pyjeve shtetërore Bashkia Kolonjë*” me afat deri në datën 30.06.2017 është shkaktur dëmi ekonomik në shumën 3,500,000 lekë me tvsh për buxhetin e Bashkisë Kolonjë, shpenzim i paligjshëm i shkaktuar si rezultat i dorëzimit me vonesë të sasisë prej 2926.1 mst dru zjarri jashtë afatit të parashikuar në kushtet e kontratës, ndërsa komisioni i marrjes në dorëzim nuk ka përllogaritur dëmin e shkaktuar si pasojë e dorëzimit me vonesë të sasisë së druve të zjarrit, në mospërputhje me neni nr. 8 “*Të drejtat dhe detyrimet e veçanta të kontraktuesit dhe kontraktorit*”, pikat nga (8.4 deri 8.13), neni nr.19 “*Vonesat në zbatim dhe zgjatja e afatit*”, pika 19.4 dhe neni nr.20 “*Likuidimi i dëmeve për dorëzim të vonuar*”, germa (a); “*Për kontrata me periudhë zbatimi jo më shumë se 6/muaj tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalishtë mbi 25% të vlerës së kontratës*”.
(Trajtuar më hollësisht në faqet 123-126 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

2.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të marr masa dhe të analizojë vlerën **3,500,000 lekë** e cila **përbën të ardhura të munguara** për buxhetin e Bashkisë Kolonjë, në lidhje me ndjekjen e afateve të dorëzimit të mallit duke gjetur rrugë alternative të përballimit të risqeve si rezultat i ndryshimeve të paparashikuara të motit pavarësisht amendimit në kontratën e furnizimit.

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 57, pika 2; 58 “*Ilojet e masave disiplinore*” shkronja “ç”, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*” dhe nenin 64, shkronjat “g” dhe “k”, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, i

rekomandojë Kryetarit të Bashkisë që t'i kërkojë Komisionit Disiplinor, pranë Bashkisë Kolonjë, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil” për 3 punonjësit e auditit të brendshëm, si më poshtë:

- 1- [REDAKTUAR], me detyrë Përgjegjës i Auditit të Brendshëm
- 2- [REDAKTUAR], me detyrë Auditues i Brendshëm
- 3- [REDAKTUAR], me detyrë Auditues i Brendshëm

Për mos përmbushje të rëndë të detyrës pasi NJAB ka raportuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik pranë MF me shkresë nr. 324, datë 14.02.2018 Raportin Vjetor dhe evidencat e veprimtarisë së NJAB për vitin 2017 i cili përfshin ndër të tjera auditimet e kryera për vitin 2017, përbërja profesionale dhe niveli i kualifikimit të punonjësve të AB, realizimi i planit të auditimeve janar – dhjetor 2017, gjetjet e ndara sipas prioriteteve, parregullsitë e identifikuara sipas sistemeve, rekomandimet e dhëna dhe pyetësorët e vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm, në përmbushje të detyrimit me përcaktimet në nenin 14 të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm por, nga auditimi i evidencës bashkëlidhur raportimeve dhe atë të grumbulluar për auditim si dhe nga ballafaqimi, rezulton se për vitin 2017 janë planifikuar e miratuar gjithsej 28 angazhime auditimi por duke specifikuar vetëm një njësi “Drejtorinë e financës dhe ekonomisë”, janë realizuar 26 dhe 2 në proces, në fakt është dokumentuar vetëm një auditim në Drejtorinë e Financës dhe Ekonomisë i cili në kohën e ushtrimit të auditimit është në fazën e projektraportit. Nga komunikimi dhe ballafaqimi rezulton se janë kryer auditime por nuk janë mbajtur letrat e punës në kundërshtim me ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 14 dhe 16, dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm. Në këto kushte raportimi ka qenë fiktiv dhe kjo njësi nuk ka përmbushur detyrimin për vitin 2017 për të dhënë garanci të arsyeshme, nëpërmjet kryerjes së angazhimeve të auditimit dhe dokumentimit të tyre sipas përcaktimeve në ligj, institucionit mbi rregullshmërinë e veprimtarisë, përputhshmërinë me kuadrin rregullator në fuqi dhe përdorimin me sa më dobi të fondeve të institucionit.

Shënim: Në rastin e fillimit të proceseve gjyqësore në funksion të zbatimit të këtij rekomandimi, nga ana e Bashkisë, të kërkohej prezenca e KLSH-së, si palë e tretë në proces gjyqësor, duke e njoftuar me shkresë zyrtare KLSH-në, në lidhje me ecurinë dhe zhvillimet përgjatë procesit gjyqësor dhe në të gjitha shkallët e gjykimit.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R